



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 93 prot.

Tiranë, më 17. 01. 2023

V E N D I M

Nr. 5, datë 17. 01. 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, mori në shqyrtim ankesën nr. 168 Regj., datë 08.11.2022, e E. S.², kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike³ sh.a., me pretendimin e diskriminimit për shkak të gjendjes ekonomike, gjendjes shoqërore (e divorcuar), moshës, gjendjes familjare, gjendjes martesore dhe gjendjes civile.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “...jam nënë kryefamiljare dhe e divorcuar prej 5 vitesh. Gjithë këtë kohë kam hasur në shumë problematika të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me mbijetesën time dhe të djalit tim autik D. S. dhe A. S. Kam 5 vjet pa punë pas kërkesave të shumta për punësim në Drejtorinë e Punësimit Tiranë. Gjithë këto vite që pas divorcit unë po mundohem të mbijetoj bashkë me dy 2 djemtë e mi, vetëm me pagesën që marr nga Njësia Administrative nr. 3, prej 10 mijë lekë invaliditet dhe 10 mijë lekë kujdestari, të gjitha këto janë për 3 persona. Ndërkohë minimum jetik për person është 20 mijë lekë. Me këtë pagesë qesharake është e pamundur të mbijetosh pavarësisht që çmimet sa vijnë dhe rriten.

Unë jetoj në një apartament që nuk është i imi, por që është i ish vjehrrës dhe po më kërkohet që të liroj këtë banesë pasi gjyqi nuk më dha pjesën që më takonte si bashkëshorte. Arsyeja që ish bashkëshorti më kërkoi të dal nga banesa është sepse do ta japi me qira dhe unë nuk kam

¹ Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

² Plotësuar nga ankuesja, në datë 02.12.2022, mbajtur me Procesverbal pranë Zyra të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

³ Në vijim referuar me akronimin OSHEE.

mundësi të paguaj këtë qira dhe as ndonjë shtëpi tjetër me qira më të lirë, duke qenë se të ardhurat e mia janë 20 mijë lekë në muaj. Përveç të gjithë problemeve të mësipërme kam edhe problem me faturën e energjisë elektrike dhe të ujit të cilat më vijnë shumë të larta edhe pse më janë prerë fare në datën 01.10.2021. Kam deklaruar se nuk e paguaj dot debinë dhe mi kanë prerë, kam njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Prokurorinë që të verifikojnë, kam marrë përgjigje negative dhe asnjë drejtor nuk pranon të më takojë që të zgjidh problemin, ndërkohë jetoj pa një dritë, pa mirëqenie dhe pa punë, pa shtëpi...”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për shkak të gjendjes ekonomike, gjendjes shoqërore (e divorcuar), moshës, gjendjes familjare, gjendjes martesore dhe gjendjes civile.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së⁴, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010, i ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

⁴Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1456/1 prot., datë 07.12.2022, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 8945/1 prot., datë 23.12.2022, Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a.⁵ (FSHU), ka dërguar parashtrimet dhe dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri, si dhe ka informuar ndër të tjera, se:

“Nga verifikimet e kryera në sistemin tonë të faturimit rezulton se titullari i kontratës së sipër përmendur nuk është i njëjtë me ankuesin. Ndodhur në këto kushte informacioni për kontratën e energjisë elektrike në bazë të parashikimeve të ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe sipas parashikimeve të kontratës së furnizimit me energji elektrike të lidhur midis FSHU sh.a. dhe klientit, i vendoset në dispozicion vetëm titullarit të saj ose përfaqësuesit ligjor.

Gjithsesi ju informojmë se kjo kontratë rezulton me debi të akumuluar dhe titullari i kontratës është i detyruar të shlyejë detyrimet brenda afatit kohor. Sikurse parashikohet në kontratën midis palëve, vonesat në likuidimin e detyrimit nga ana e konsumatorit sjellin ngarkesën me kamatëvonesë dhe ndërprerjen e energjisë elektrike, referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të ankuesit nga ana e Shërbimit Social Shtetëror.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

⁵ Pjesë e OSHEE Group

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet se: *“1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedurë, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”*.

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a dhe b⁶, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;

⁶ Neni 20/1/a dhe b, të ligjit nr. 10221/2010: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi...”*

- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar ndonjë trajtimi të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e saj për të përfituar të mira apo shërbime dhe më konkretisht në lidhje me ndërprerjen e energjisë elektrike.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Subjekti ankues është nënë e një djali me aftësi të kufizuara, kryefamiljare dhe e divorcuar prej 5 vitesh. Aktualisht prej disa vitesh, ajo bashkë me dy djemtë e saj jeton në banesën e ish vjehrrës së saj, shtetases T. S.

Sipas ankueses, në banesën ku jeton, që prej muajit tetor të vitit 2021, për shkak të debisë së akumuluar dhe pamundësisë për ta paguar, nga ana e FSHU-së i është ndërprerë energjia elektrike.

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimit të subjektit ankues, Komisioneri ka analizuar aktet ligjore e nënligjore, të cilat përcaktojnë garantimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, duke marrë në konsideratë interesat e tyre, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike.

Ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 24 e tij parashikon se: “Klient” është një klient shumice ose fundor i energjisë elektrike”.

Në nenin 82⁷, të tij Ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, përcakton se:

“Furnizuesit, përveç të drejtave të përcaktuara në kontratë, sipas nenit 80, të këtij ligji, kanë këto të drejta: a) të përdorin, sipas kushteve të rregulluara, shërbimet e operatorit të tregut, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në bazë të rregullave të tregut, Kodeve të Rrjetit dhe kontratave përkatëse; b) të kenë akses në sistemin e transmetimit dhe sistemin e shpërndarjes, në përputhje me dispozitat për aksesin e palëve të treta, të përcaktuar në nenin 29, të këtij ligji. c) të kërkojnë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, kur klienti nuk përmbush detyrimet kontraktore, dhe rilidhjen e energjisë elektrike, kur klienti ka përmbushur detyrimet, të cilat shkaktuan ndërprerjen e furnizimit”.

Lidhur me aktet nënligjore të nxjerra sa i përket Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë, Komisioneri vëren se:

⁷ Të drejtat e furnizuesit.

Neni 15 i Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.01.2018, parashikon pasojat e mos pagesës, duke cituar se: *“15.1 Në mungesë të pagesës nga Klienti të faturës brenda 30 ditëve nga kalimi i afatit të caktuar për pagesë sipas nenit 13.1, Furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të Klientit...”*.

Nga analiza e provave të administruara, kontrata me numër TR2E120036095238, për të cilën ankuesja pretendon se është diskriminuar si rezultat i ndërprerjes së energjisë elektrike, rezulton se nuk është lidhur ndërmjet saj dhe FSHU-së, por evidentohet që është në pronësi të shtetases T. S. Gjithashtu, rezulton se kjo kontratë ka akumuluar debi dhe sikurse parashikohet në Kontratën e Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike, vonesat në likuidimin e detyrimit nga ana e konsumatorit sjellin ngarkesën me kamatëvonesë dhe ndërprerjen e energjisë elektrike në rast të mospagimit të detyrimeve të prapambetura.

Për rrjedhojë, në analizë të sa më sipër, Komisioneri gjykon se, nga ana e FSHU-së nuk ka patur veprime të padrejta, të pafavorshme apo të paligjshme kundrejt ankuses, përse ajo ka pretenduar. Nga analiza e akteve të sipërcituara dhe provave të administruara, FSHU pavarësisht faktit që kontrata e energjisë elektrike nuk ka qenë në emër të subjektit ankues dhe ka akumuluar detyrime të pa likuiduara ndaj saj, rezulton se në muajt tetor-dhjetor 2022, banesa në të cilën jeton ankuesja është furnizuar me energji elektrike.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përrjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”*

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.*

Neni 20/1 i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht:

“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për

shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Furnizuesit të Shërbimit Universal.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri, arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e FSHU, kundrejt ankuseses, për shkaqet e pretenduara prej saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, E. S., për shkak të gjendjes ekonomike, shoqërore (e divorcuar), moshës, gjendjes familjare, gjendjes martesore dhe gjendjes civile, nga ana e Furnizuesit të Shërbimit Universal, në fushën e të mirave dhe shërbimeve.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: gjendja ekonomike, shoqërore (e divorcuar), moshë, gjendja familjare, martesore dhe civile)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)